



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/03
Datë: 09.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 dhe 5 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2011, mori

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës në cilësinë e ushtruesit të ligjshëm të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës, në Ndërmarrjen Publike Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK), Sh.A., vendos të kërkojë nga PTK dhe Bordi i saj i drejtorëve që të deklarojë dhe të paguajë një dividendë "Dividentë" për aksionarin në shumën prej 40,000,000.00 (dyzetë milionë) euro.
2. Afatet e pagesës do t'i caktojë Ministri i Financave në bashkëpunim me Bordin e drejtorëve të PTK-ës.
3. Obligohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/03
Datë: 09.03.2011


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-05 dt. 22.02.2011, nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, dhe paragrafit 3 të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 01/2007 si dhe bazuar në rekomandimet e Komisionit Ndërministror të themeluar me qëllim të analizimit të opsioneve për participimin e sektorit privat në PTK, Qeveria e Republikës së Kosovës, në cilësinë e ushtruesit të ligjshëm të të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjen Publike "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh. A. ("PTK"), Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2011, mori:

V E N D I M

1. Të ofrohen për tenderim dhe shitje 75% (shtatëdhjetepesë për qind) të aksioneve të Ndërmarrjes Publike PTK, SH.A.
2. Themelohet Komisioni Qeveritar për Privatizimin e PTK-ës në këtë përbërje:

2.1 Z. Besim Beqaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik,	kryesues;
2.2 Znj. Mimoza Kusari-Lila, Ministre e Tregtisë dhe Industrisë,	anëtare;
2.3 Z. Fehmi Mujota, Ministër i Infrastrukturës,	anëtar;
2.4 Z. Nenad Rashiç, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale,	anëtar;
2.5 Z. Bedri Hamza, Ministër i Financave,	anëtar.
3. Komisioni Qeveritar për Privatizim të ndjekë një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese, në përputhje me kushtet procedurale të parapara me ligjet e Republikës së Kosovës dhe me standardet më të larta ndërkombëtare.
4. Komisioni Qeveritar për Privatizim të adresojë dhe negociojë, në mënyrë të përgjegjshme-sociale kërkesat e arsyeshme të punëtorëve të PTK, SH.A.
5. Komisioni Qeveritar për Privatizim autorizohet të vendosë për detajet e ndarjes së aseteve të Postës nga njësitë tjera të biznesit, duke marrë parasysh:

- 5.1 interesin e Shtetit të Kosovës për të pasur një subjekt postar funksional;
5.2 maksimizimin e çmimit të shitjes së PTK SH.A.
6. Të sigurohet që njësia e biznesit posta e PTK SH.A, të shërbejë si ofrues universal i shërbimeve postare edhe gjatë procesit të ndarjes ligjore të njësisë së biznesit Posta, e cila ndarje do të bazohet në marrëveshjen paraprake për alokim të aseteve, me apo pa obligimin që të kthehet në pronësinë e Republikës së Kosovës.
 7. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që këtë vendim t`ia procedojë për aprovim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
 8. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/130 i datës 16.06.2010.
 9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/03

Datë: 09.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2011, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet, me ndryshime, Plani i Veprimit për dhjetë Prioritete Kyçe të Qeverisë në fushën e Integritimit Evropian.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian për përfshirjen e vërejtjeve.
3. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e planit të veprimit nga pika 1. e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/03

Datë: 09.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2011, mori:

V E N D I M

1. Autorizohet Ministri i Financave që të aprovojë transfere nga programi shpenzime të paparashikuara për shumat individuale të kërkuara deri në vlerë prej 20,000.00 (njëzetmijë) euro.
2. Shuma e totalit të këtij autorizimi nuk mund të kalojë 20 % (njëzet për qind) të shumës së ndarë vjetore të programit – shpenzimet e paparashikuara.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zbatohet deri më 31.12.2011.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/03
Datë: 09.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2011, mori:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 5,000.00 (pesëmijë) euro për familjen e fëmijës së vvarë, Leutrim Musliu nga fshati Uglar, Komuna e Gjilanit.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezervat e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe transferohen në xhirollogarinë bankare të z. Rahim Musliu, në bankën Pro Credit Bank Nr.1150153612000121.
3. Obligohet Ministra e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë